

Procesverbal - Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje kancelari për nevoja të Shoqërisë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Dosje 22852000-7

Stilolapsa 30192124-6

Vlera e fondit limit: 1.500.000 (nje milion e peseqind mije) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4 ;përkatësisht në 30.000 (tridhjetë mije) leke

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.

”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit

duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujve sipas specifikimeve teknike të DST-së.

Mostrat duhet të jenë të etiketuara qartë me emrin e operatorit ekonomik dhe numrin përkatës të artikullit perkatesisht artikujt me nr rendor: 1,2,3,12,14,23,31,40,44,45,46,47.

Mostrat do të përdoren nga Autoriteti Kontraktor për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofertuara me specifikimet teknike dhe dokumentacionin e paraqitur në ofertë.

Mostra duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i

kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Argumentim: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me specifikimet teknike dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me piken 6/a, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. bazuar në Udhëzimin Nr. 2 datë 02.05.2019. Faza e paraqitjes së mostrave i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ana jonë. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në piken 6 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ose deklaratë konformiteti të lëshuar nga prodhuesi i dosjeve prej kartoni dhe dosjeve plastike, me anë të së cilës të vërtetohet se materialet e përdorura në prodhimin e tyre nuk përmbajnë substanca të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe janë të sigurt për përdorim në ambiente zyre, në përputhje me standardet dhe legjislacionin përkatës në fuqi ose ekuivalent.

Në rast se certifikata është lëshuar nga një laborator ose organ i pavarur i vlerësimit të konformitetit, ajo duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e një certifikate ose deklarate konformiteti të lëshuar nga prodhuesi, me anë të së cilës vërtetohet se materialet e përdorura në prodhimin e dosjeve prej kartoni dhe plastike nuk përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut, është vendosur në funksion të

garantimit të sigurisë së produkteve që do të përdoren nga punonjësit e Autoritetit Kontraktor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të përditshme.

Dosjet prej kartoni dhe plastike janë materiale që përdoren në mënyrë të vazhdueshme dhe kanë kontakt të drejtpërdrejtë me përdoruesit në ambientet administrative. Për këtë arsye është e nevojshme të garantohet se materialet e përdorura në prodhimin e tyre nuk përmbajnë substanca të rrezikshme ose përbërës kimikë që mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut ose për mjedisin.

Kjo kërkesë synon të sigurojë që produktet e furnizuara janë prodhuar në përputhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë, duke garantuar përdorimin e materialeve të sigurta, të përshtatshme për ambiente pune dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Gjithashtu, kërkesa shërben për të garantuar gjurmueshmërinë e produkteve dhe përgjegjësinë e prodhuesit mbi përbërjen dhe cilësinë e materialeve të përdorura.

Kriteri është në përputhje me nenin 36 dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", pasi lidhet drejtpërdrejt me cilësinë dhe sigurinë e mallrave objekt prokurimi, është proporcional me natyrën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën, duke lejuar paraqitjen e dokumenteve të lëshuara nga prodhuesi ose dokumenteve ekuivalente që provojnë përmbushjen e të njëjtit standard sigurie.

Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë.

Objekti i kësaj procedure është furnizimi me artikuj kancelarie për nevojat e veprimtarisë së përditshme administrative të UKT sh.a me qëllim sigurimin e vijimësisë së proceseve të punës në të gjitha drejtoritë, sektorët dhe njësitë organizative të institucionit. Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor, konsumit historik, numrit të punonjësve, volumit të dokumentacionit administrativ dhe kërkesave funksionale të proceseve të punës.

Artikujt e kërkuar janë përcaktuar sipas karakteristikave minimale teknike dhe funksionale që duhet të plotësojnë, duke shmangur çdo referencë ndaj markave, prodhuesve ose origjinës së

veçantë, me qëllim garantimin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe respektimin e parimit të konkurrencës.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë cilësinë, jetëgjatësinë, funksionalitetin dhe përdorimin e përditshëm të artikujve kancelarikë. Për këtë arsye janë përcaktuar karakteristika minimale si përmasat, gramatura, trashësia e materialeve, kapaciteti, lloji i mekanizmave, cilësia e plastikës apo kartonit, dimensionet e artikujve dhe parametrat teknikë të nevojshëm, të cilët garantojnë përdorim normal dhe jetëgjatësi të produkteve gjatë periudhës së kontratës.

Për artikujt që përdoren për arkivimin dhe administrimin e dokumentacionit, si dosjet, kutitë e arkivës, qeset plastike, kapëset, zarfet dhe artikuj të ngjashëm, janë përcaktuar kërkesa minimale lidhur me dimensionet, trashësinë dhe cilësinë e materialeve, me qëllim garantimin e ruajtjes së sigurt të dokumenteve dhe shmangien e dëmtimeve gjatë përdorimit dhe arkivimit afatgjatë.

Për artikujt e shkrimit, si stilolapsat, markerët, evidenciatorët, lapsat, bojërat e vulave dhe korrektorët, janë përcaktuar kërkesa minimale që lidhen me cilësinë e bojës, trashësinë e majës, rezistencën në përdorim dhe funksionalitetin, me qëllim sigurimin e produkteve të përshtatshme për përdorim të vazhdueshëm në administratë.

Për pajisjet kancelarike, si makinat stapler, hapëset e vrimave, makinat llogaritëse, mbajtëset metalike të dokumenteve dhe aksesoret e tjerë, janë përcaktuar parametra minimalë teknikë që garantojnë qëndrueshmëri mekanike, funksionim të sigurt dhe jetëgjatësi në përdorim.

Për artikujt me identitet institucional, si badge-t me logo dhe rripat mbajtës të badge-ve, specifikimet janë hartuar në funksion të identifikimit të punonjësve të Autoritetit Kontraktor dhe paraqitjes së unifikuar të identitetit institucional, duke garantuar cilësi të materialeve dhe rezistencë gjatë përdorimit të përditshëm.

Sasitë e kërkuara janë përcaktuar mbi bazën e konsumit të viteve të mëparshme, nevojave operative të njësive organizative dhe planifikimit të nevojave për periudhën e zbatimit të kontratës, me qëllim sigurimin e furnizimit të pandërprerë dhe shmangien e procedurave të shpeshta të prokurimit.

Njësia e prokurimit vlerëson se të gjitha specifikimet teknike janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, janë objektive, proporcionale dhe të domosdoshme për realizimin e saj, pa krijuar kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë. Çdo operator ekonomik mund të ofertojë produkte që plotësojnë ose tejkalojnë parametrat minimalë teknikë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në të gjitha rastet kur në specifikimet teknike mund të përmendet ndonjë standard, karakteristikë teknike, referencë ose element identifikues, do të pranohen edhe zgjidhje ekuivalente, në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Njesia e Prokurimit